



## KOMUNIKATË

16.02.2010

Në mbledhjen e 16-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pas miratimit të rendit të ditës, kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, ka kërkuar miratimin e raporteve 51, 53, 55, 56,71 dhe 72 të vitit 2009. Anëtarët e KQZ-së i kanë miratuar këto raporte me nevojën që raportet të jenë më koncize dhe më të kompletuara. Në vazhdim Alban Muriqi, zyrtar ligjorë, e ka informuar KQZ-në me ndryshimet për këshilltarët komunal të katër komunave. Zëvendësimet janë bërë për shkak se këshilltarët e caktuar të këtyre katër komunave, janë emëruar në postet e ndryshme udhëheqëse komunale. KQZ ka miratuar zëvendësimet e këshilltarëve për komunën e Vitisë ( 1), të Shtimes (1), të Gjakovës (4) dhe të Prishtinës (4).

Në vazhdim të mbledhjes, KQZ ka shqyrtuar autorizimin e Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve të Drenasit për përfaqësimin e KQZ-së në Gjykatën Komunale të Drenasit. Shqyrtimi lidhet me abuzimet e komisionerëve në vendvotime, gjatë procesit të votimit për Zgjedhjet Qendrore të vitit 2007. KQZ ka vlerëson se Zyrtari i Lartë Komunal i Drenasit, është personi më adekuat që mund ta përfaqësoj KQZ-në në këtë kontest.

Gjithashtu, KQZ ka shqyrtuar edhe kërkesën e Prokurorisë Publike të Gjakovës për sigurimin e materialit zgjedhor lidhur me procedurën e hetimeve e cila zhvillohet për parregullsitë e Zgjedhjeve Lokale në këtë komunë. Prokuroria ka kërkuar sigurimin për ekzaminim të materialit të fletëvotimeve të katër (4) vendvotimeve, ankesat e subjektit politik dhe provat e tjera. KQZ pas shqyrtimit, ka ardhë në përfundim se duhet që prokurorisë t'i dërgohet procesverbali, ankesat dhe materiali tjetër dhe t'i propozojë prokurorisë që, për shkak se materiali është voluminoz dhe në pamundësi të dislokimit të tij, në bashkëpunim me KQZ/QNR të bëjë të gjitha shiqimet dhe ekzaminimet e nevojshme të këtij materialei.